Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0789

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga:Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Med Plus" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-se-Prizren Lot1"me nr. të prokurimit:"622-23-5623-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit, me datën 22.12.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik"Med Plus" SH.P.K , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 13.10.2023 (me numër protokolli 789/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-se-Prizren Lot-1" me nr. të prokurimit: "622-23-5623-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit .
2.Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim Lot -1.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 01.06.2023, Komuna e Prizrenit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-se-Prizren Lot1” me nr. të prokurimit: "622-23-5623-1-1-1”. Nderkaq me datën 02.10.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE“Med Plus” SH.P.K me datën 06.10.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK-Komuna e Prizrenit merr vendim qe te refuzohet si e pa bazuar kërkesa per ri-shqyrtim e OE“Med Plus” SH.P.K. . lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-se-Prizren Lot1” me numër te prokurimit: "622-23-5623-1-1-1" inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues“Med Plus” SH.P.K me datën 13.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 789/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës:furnizim, vlera e parashikuar e kontratës:170,000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 25.10.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE“Med Plus” SH.P.K

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“Med Plus” SH.P.K , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 13.10.2023 (me numër protokolli 789/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-se-Prizren Lot1“ me nr. të prokurimit: "622-23-5623-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit .
II.Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.
PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Sqarim hyrës,

Aktiviteti i prokurimit me titull “Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna per nevojat e QKMF-se-Prizren” me nr te prokurimit "622-23-5623-1-1-1", paraqitet per here te dytë në OSHP. OE ankues i tanishëm “MEDPLUS shpk” ka qene i rekomanduar per kontratë herën e parë dhe tani është ankues, ndërsa i rekomanduar për kontratë është OE “MADEKOS Sh.p.k”.

Në ekspertizën 617/2023 të datës 05.09.2023, në rekomandimin përfundimtar të lëndës kam theksuar se aprovohet ankesa e OE ankues (“MADEKOS”) dhe lënda te kthehet në rivlerësim. Autoriteti Kontraktues dhe OE ankues janë pajtuar me rekomandimin dhe Paneli shqyrtues ka nxjerr vendim për pajtim të palëve, vendimi nr.617/2023 i dt. 20.09.2023.

Pretendimi ankimor i OE ankues 1

Përmbledhje e pretendimit ankimor 1

OE ankues thekson se: Ne jemi eliminuar me arsyetimin se kemi ofruar çmim jo normalisht të ulët duke u bazuar në formulën sipas tabelës për për llogaritjen e çmimeve jo normalisht të ulëta.

Sipas nenit 41.3 të rregullores së lartpërmendur kur të përmbushen të tri kushtet e përcaktuar në këtë dispozitë atëherë kërkohen sqarime.

Autoriteti kontraktues nuk e ka dëshmuar se janë përmbushur të tri kushtet me rastin e kërkesës për sqarime. Pavarësisht këtij fakti, edhe nëse janë plotësuar të tri kushtet, duhet të kërkohen sqarime dhe të zbatohet procedura inter partes. Sqarimet janë kërkuar nga ana e AK-së, mirëpo me rastin e eliminimit është cekur se kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta sipas formulës ligjore. Kur kërkohen sqarime dhe kur ofrohen sqarimet atëherë ose duhet të merren parasysh sqarimet ose nëse nuk merren parasysh atëherë duhet të jepen arsyetime konkrete. Ne kemi ofruar sqarime në detaje në lidhje me çmimet e ofruara nga ne dhe e kemi dëshmuar me dokumente konkrete se mund ta përfundojmë këtë kontratë, madje kemi shpreh gatishmërinë që të pranojmë edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit nëse e sheh të arsyeshme AK-së për të garantuar implementimin e kësaj kontrate. Duke pasur parasysh të gjitha sqarimet që i kemi dhënë me shkrim, dëshmitë tjera ku kemi dëshmuar se nuk kemi çmime jo normalisht të ulëta si dhe gatishmërinë tonë që të pranojmë rritjen e sigurimit të ekzekutimit, atëherë kuptohet qartë se ne nuk kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta dhe këtë e kemi argumentuar, prandaj arsyeja e eliminimit është paqëndrueshme dhe e pa bazuar. Autoriteti kontraktues kur e ka kuptuar se ne i kemi arsyetuar çmimet e ofertës tonë, atëherë ka bërë një kthim mbrapa në procedurë ku pa sqarimeve të kërkuara dhe të pranuara është kthyer tek tabela duke u arsyetuar se kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta sipas tabelës ligjore. Nga ky veprim i AK-së kuptohet qartë se AK-ja në mënyrë implicite i ka pranuar arsyetimet tona dhe nuk ka mundur të na eliminojë për këtë pikë por është kthyer tek tabela e çmimeve.

Përgjigjje në Pretendimin Ankimor 1

Eksperti Shqyrtues, sqaron se OE ankues “MEDPLUS Sh.p.k”, i ka plotësuar të tre kushtet sipas nenit 41 paragrafi 3 i rregullores për prokurim publik që AK të kërkojë sqarime dhe meqë AK në herën e kaluar nuk ka respektuar Nenin 61 të LPP-së dhe Nenin 41 të rregullores për prokurim publik, andaj kam kërkuar që: citat nga ekspertiza nr.617/23 “*në rivlerësim të AP, AK-ja të ndjek procedurën inter partes dhe të veproj në harmoni me Nenin 41 paragrafi 6 i Rregullores për prokurim Publik Nr. 001/2022, si dhe të konstatoj nëse çmimet e ofruara janë sipas çmimeve të*

tregut", mbyll citatin.

Në rivlerësimin e Aktivitetit të Prokurimit, Autoriteti Kontraktues me datë 21.09.2023 ka kërkuar sqarime nga OE "MEDPLUS sh.p.k", ndërsa me datë 25.09.2023 OE "MEDPLUS Sh.p.k" i është përgjigjur AK-së duke i arsyetuar çmimet e ofruara si dhe duke i bashkangjitur dëshmi dokumentare si Faturë dhe pro faturë për çmimet e pretenduara si jo normalisht të ulëta nga ana e AK-së.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se AK-ja nuk ka marrë për bazë dëshmitë e ofruara nga OE ankues, por vetëm është thirrur në ekspertizën e eksperti shqyrtues nr.617/23 dt.05.09.2023, dhe pikërisht në këtë ekspertizë është rekomanduar AK që të konstatoj nëse çmimet e ofruara janë sipas çmimeve të tregut dhe AK nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që i ka konstatuar çmimet e tilla.

Eksperti Shqyrtues, është mbështetur në paragrafin 2 të nenit 40 të rregullores për prokurim publik ku ndër të tjera theksohet se: Citat "..... *Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar" mbyll citatin*. Andaj rekomandimet e ekspertit shqyrtues ne ekspertizën nr. 617/2023 dt. 05.09.2023 nuk kanë nënkuptuar detyrimisht ndryshim të gjendjes fillestare, por është rekomanduar që të zbatohet në tersi dispozita e nenit 61 të LPP-së si dhe neni 41 i rregullores për prokurim publik, dhe aq më tepër kur janë ofruar dëshmi si Fatura dhe pro fatura si dhe pas sqarimeve AK është dashur të ketë në konsideratë dëshmitë e ofruara.

Andaj, eksperti shqyrtues e sheh pretendimin e OE ankues si të bazuar për faktin se dëshmitë e ofruara si Fatura dhe pro fatura, janë dokumente të cilat vërtetojnë se produket (pozicionet) e kontestuara nga OE i rekomanduar për kontratë që herën e kaluar ishte OE ankues, mund të ofrohen me çmime të cilat OE ankues ka ofertuar në këtë AP, dhe AK për çështje eventuale të sigurisë ka mundur të kërkojë rritjen e Sigurisë së Ekzekutimit pasi ka ndjekur fillimisht procedurën "Inter Partes".

Ndërsa në lidhje me mosrespektimin e 108/A ku OE ankues pretendon se AK nuk i ka dhënë përgjigjje në vendimin e kërkesës për rishqyrtim, dhe ka refuzuar si tërsi, eksperti shqyrtues sqaron se paragrafi 9 i nenit 108/A i LPP-së e obligon AK që refuzimin ta arsyetoj, dhe në rastin konkret AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar duke u thirrur në : "*Komisioni Vlerësues i AK duke u bazuar në ekpsertizën e ekspertit të OSHP-së edhe në vendimin e P.SH. me nr.2023/0617 ka bë Ri-vlerësimin e ofertave duke llogaritur çmimin e dhan nga OE sipas formulës ligjore çmimit jo normalisht të ulët.*

Gjatë llogaritjes sipas formulës ligjore në bazë të çmimeve të dhana nga operatorët ekonomik na del se OE i rekomanduar nga AK për kontratë MEDPLUS me çmimin prej 5.97 sipas cmmit të peshuar euro ka ofertuar me çmimin JO NORMALISHT TË ULËT dhe si i tillë është i pa përgjeshëm.

Andaj, eksperti shqyrtues rekomandon që në rivlersim të Aktivitetit të Prokurimit, AK-ja të respektoj në tërsi dispozitat e LPP-së si dhe të ketë parasysh nenin 1, 7 dhe nenin 60 të LPP-së.

- Konstatimet e panelit shqyrtues -

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit

shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin. Po ashtu vlenë të theksohet se për këtë aktivitet të prokurimit ka ekzistuar edhe një vendim i OSHP me Nr. 2023/0617, i datës 20.09.2023

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Sa i përket pohimit ankimor të ankuesit për eleminimin e AK nga pjesëmarrja për çmime jo-normalisht të ulëta, eksperti i njëjtë shqyrtues këtë çështje e ka veçuar dhe cituar se kjo është trajtuar me vendimin paraprak të lartëcekur, ku në rastin paraprak ka qenë i rekomanduar për kontratë e tani ankues. Eksperti shqyrtues ka rekomanduar për AK që të zbatohet në tersi dispozita e nenit 61 të LPP-së si dhe neni 41 i rregullores për prokurim publik. Lidhur me këtë raport të ekspertizës së AK është pajtuar se ka çmime jo normalisht të ulta, kështu që paneli shqyrtues e ka nxjerrur vendimin Nr. 2023/0617 më dt. 20.09.2023, se përfundon administrativisht procedura e shqyrtimit të ankesë për shkak të pajtimit të palëve. Paneli shqyrtues konstaton që vendimi paraprak është respektuar, lënda është kthyer në ri-vlerësim dhe janë kërkuar informacionet shtesë sa i përket ofertës tani të ankuesit "MED PLUS" SHPK dhe për këtë paneli shqyrtues e mbështet ekspertin shqyrtues në rekomandimin e tij se " OE ankues si të bazuar për faktin se dëshmitë e ofruara si Fatura dhe pro fatura, janë dokumente të cilat vërtetojnë se produket (pozicionet) e kontestuara nga OE i rekomanduar për kontratë që herën e kaluar ishte OE ankues, mund të ofrohen me çmime të cilat OE ankues ka ofertuar në këtë AP, dhe AK për çështje eventuale të sigurisë ka mundur të kërkojë rritjen e Sigurisë së Ekzekutimit pasi ka ndjekur fillimisht procedurën "Inter Partes". Andaj, AK nuk ka vepruar në plotni me dispozitat ligjore duke mos e arsyetuar mos bindjen e tyre karshi faturave dhe profaturave të ofruara nga ankuesi.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në haromoni me dispozitat e nenit 1, 7 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 6 dhe 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **MEDPLUS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: